VENDIM
Nr. 584, datë 8.10.2021

PËR SHPALLJEN E GJENDJES SË EMERGJENCËS NË FURNIZIMIN ME ENERGJI ELEKTRIKE

(ndryshuar me vendimin e KM-së nr. 256, datë 29.4.2022, nr. 650, datë 10.10.2022, nr. 449, datë 26.7.2023)

(i përditësuar)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës "ç", të pikës 1, të nenit 90, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe të ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

2. Ngritjen e grupit ndërinstitucional për menaxhimin e emergjencës në furnizimin me energji elektrike, që drejtohet nga zëvendëskryeministri dhe ka në përbërje ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, ministrin e Financave dhe Ekonomisë dhe çdo përfaqësues nga institucione të tjera, që vlerësohen të nevojshëm nga zëvendëskryeministri.

2/1. Vendosjen e detyrimit të shërbimit publik ndaj prodhuesve me përparësi të energjisë elektrike, që kanë kontratë me shoqërinë "Furnizuesi i tregut të lirë" sh.a. Këtyre prodhuesve me përparësi i vendoset detyrimi i shërbimit publik për shitjen e energjisë elektrike te shoqëria "Furnizuesi i tregut të lirë", në përputhje me çmimin e përcaktuar nga Enti Rregullator i Energjisë, në bazë të metodologjisë së miratuar me vendimin nr. 687, datë 22.11.2017, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e metodologjisë për përcaktimin e çmimit vjetor të blerjes së energjisë elektrike, që do t'u paguhet prodhuesve ekzistues me përparësi", i ndryshuar, gjatë periudhës së gjendjes së emergjencës në furnizimin me energji elektrike.

3. Shfuqizuar.

4. Ngarkohet ministri i Financave dhe Ekonomisë që të sigurojë mekanizmat e duhur financiarë, me qëllim mundësimin e importit të energjisë për sigurimin e furnizimit të pandërprerë të energjisë elektrike.

5. Gjendja e emergjencës në furnizimin me energji elektrike i shtrin efektet deri më 31 dhjetor 2023.

6. Ngarkohen zëvendëskryeministri, ministri i Infrastrukturës dhe Energjisë, ministri i Financave dhe Ekonomisë, "KESH" sh.a., "OST", sh.a. dhe "OSHEE Group" sh.a., FTL sh.a. dhe ERE për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama